



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 11, datë 20.02.2017

Për

“PËR VENDOSJEN E SKULPTURËS “ËNDRRA FËMIJËRIE” NË PARKUN 1 KM (ISH FUSHA E AVIACIONIT)”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, shkronja “b”, neni 23, pika 9, neni 54 shkronja “m” dhe neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 143, datë 18.1.2012 për “Miratimin e listës paraprake (pjesa e parë+pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, të Qarkut të Tiranës”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Dhënien e pëlqimit për vendosjen e skulpturës “Ëndrra Fëmijërie” në parkun 1 km (ish fusha e aviacionit), (sipas Genplanit bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETAR

ALDRIN DALIPI